



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 26/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A... Sh.p.k., me numër unik identifikues, me seli komuna Graçanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatura Sh.p.k., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Shëndetësisë, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit nr. prot. 05-5609/2 të datës 19.09.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 03.10.2022, në mungesë të palëve, me datë 13.10.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A... Sh.p.k., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër protokolli 05-5609/2 të datës 19.09.2018 të nxjerrë nga i padituri Inspektorati Shëndetësorë i Ministrisë së Shëndetësisë.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A... Sh.p.k., ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Inspektoratit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë nr. prot. 05-5609/2 të datës 19.09.2018 si jo i ligjshëm, me arsyetimin se i padituri ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe si rrjedhojë gabimisht ka aplikuar dispozitat materiale juridike. Gjithashtu ka theksuar se në arsyetimin e vendimit thuhet se është shkelur neni 6 i UA 02/2010, por jo në dispozitiv të vendimit të atakuar, e cila paraqet shkelje esenciale me rëndësi absolute dhe si e tillë e bën vendimin e atakuar të pazbatueshëm. Po ashtu ka theksuar se vendimi i shkallës së dytë vetëm ka bërë përshkrim të vendimit të shkallës së parë duke mos u lëshuar fare në thelbësinë e ankesës dhe se një praktikë e tillë nuk duhet të lejohet andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi padia e paditësit dhe të shfuqizohet vendimi i inspektoratit shëndetësor me numër protokolli 05-5609/2 i datës 19.09.2018 dhe të detyrohet e paditura që ti barët shpenzimet e procedurës. Në seancën e shqyrtimit kryesorë nuk ka prezantuar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa me parashtrësën e datës 14.09.2022 përfaqësuesi i paditësit ka

njoftuar gjykatën se ndaj paditësit është nxjerrë Aktvendim për fillimin e procedurës së falimentimit dhe për këtë gjykatës i ka dorëzuar një kopje të Aktvendimit IV.Ek.nr. 2/2022 të datës 11.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i të paditurës është marrë konform dispozitave ligjore në fuqi dhe nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se vendimi është marrë me shkelje ligjore. Gjithashtu ka theksuar se Inspektorati Shëndetësor gjatë inspektimit të bërë tek paditësi bazuar në Ligjin për Shëndetësi nr. 04/L-125, Ligjin për Inspektoratin Shëndetësor nr. 02/L-038 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2010, ka konstatuar se regjistri i përgjithshëm i mjekëve mungonte, të dhënat për pacient ruhen në mënyrë elektronike për çfarë paditësit i është shqiptuar gjoba në lartësi prej 2,000€ (dy mijë euro) për shkak të shkeljes së nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2010, prandaj gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës. Në seancën e shqyrtimit kryesorë nuk ka prezantuar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, andaj gjykata shqyrtimin kryesor të çështjes e ka mbajtur në mungesë të palëve në procedurë në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim nr. prot. 05-5609/2 i datës 19.09.2018; Raport i inspektimit nr. prot. 05-5240 i dt. 06.08.2018; Procesverbal Nr. 004445 i dt. 18.07.2018; Fletë lëshim per pacientin M.Z; Vendim nr. prot. 05-5241 i datës 06.08.2018; Faturë për pagesën e gjobës datës 02.08.2018; Ankesë nr. prot. 05-5642 e datës 23.08.2018; Vendim nr. prot. 05-5642/2 i datës 20.09.2018; Vendim nr. prot. 05-5242 i datës 06.08.2018; Fature nr. 952 për pagesën e gjobës datës 06.08.2018; Ankesë nr. prot. 05-5609 e datës 22.08.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurit si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Inspektorati Shëndetësor i Republikës së Kosovës përmes vendimit nr. prot. 05-5242 të datës 06.08.2018, paditësit i ka shqiptuar gjobën në lartësi prej 2,000€ (dy mijë euro) për shkak të shkeljes së dispozitave të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2010.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e Inspektorati Shëndetësor, me datë 22.08.2018 ka parashtruar tek i padituri ankesë me nr. prot. 05-5609, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabueshëm të dispozitave materiale.

Kryeinspektori Shëndetësor me Vendimin nr. prot. 05-5609/2 të datës 19.09.2018 ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin me nr. prot. 05-5242 të datës 06.08.2018 me arsyetimin se vendimi i shkallës së parë është i drejtë dhe gjoba është në përputhje me nenin 6 par. 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2010 për Dokumentet Shëndetësore.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 11 par. 3 të Ligjit Nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor i cili përcakton: *“Kundër vendimit përfundimtar të Inspektoratit shëndetësor mund të ngritet kontest administrative në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.”* dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”*

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje.

Gjykata nga prova Procesverbal Nr. 004445 i dt. 18.07.2018 konstatoi se Inspektorati Shëndetësor i Kosovës gjatë inspektimit tek paditësi ndër të tjera ka konstatuar se mungon protokolli i vizitave.

Nga Prova Raport i inspektimit nr. prot. 05-5240 i dt. 06.08.2018 gjykata konstatoi se Inspektorati Shëndetësor në bazë të inspektimit të bërë me datë 18.07.2018 ka përpiluar raportin me gjendjen e konstatuar gjatë kontrollit, kur ndër të tjera në faqe 3 pika 3 ka konstatuar se *“Regjistri i përgjithshëm i mjekëve mungonte, të dhënat për pacient ruhen në mënyrë elektronike.”* me ç’rast ka rekomanduar që *“të pajisen me regjistrin e pacientëve si dhe të plotësohen sipas UA 02/2010”* dhe krejt në fund të raportit është dhënë paralajmërimi që për rekomandimet e plotësuara të njoftohet Inspektorati Shëndetësor në afat prej 10 ditë pas marrjes së raportit dhe nëse nuk plotësohen rekomandimet e dhëna nga Inspektorati Shëndetësor, do të mirën masa sipas ligjit për Shëndetësi 04/L-125 si dhe se raportin e shoqërojnë vendimet.

Nga prova Faturë nr. 952 për pagesën e gjobës datës 06.08.2018 gjykata konstatoi se paditësi në përputhje me vendimin nr. prot. 05-5242 të datës 06.08.2018 ka bërë pagesën e gjobës në shumë prej 2,000€ (dy mijë euro).

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit për shqiptimin e gjobës në shumë prej 2,000€ (dy mijë euro) për shkak se paditësi nuk ka vepruar në përputhje me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2010 për Dokumentet Shëndetësore pasi që paditësi ka mbajtur vetëm regjistër elektronik të dhënave të pacienteve, por nuk ka mbajtur regjistër manual të pacientëve.

Gjykata vlerëson se sipas par.1, pikës f) të nenit 6 të Ligjit Nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor: *“Inspektorët shëndetësor ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtim me nenin 2 të këtij Ligji si dhe mbikëqyrin: f) Mirëmbajtjen e dokumentacionit mjekësor dhe të evidencës si dhe format e raportimit në pajtim me rregullat e përcaktuara;”* Po ashtu në par. 8, 13 dhe 17 të nenit 7 të njëjtit ligj përcaktohet se: *“7.8. Bënë kontrollimin e të gjitha librave dhe dokumentet të cilat duhet t’i mbaj institucioni shëndetësor. 7.13. Urdhëron masa të tjera të nevojshme për zbatimin e ligjit apo akteve tjera nënligjore të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë. 7.17. Inspektorët shëndetësorë në pajtim me Nenin 119, të Ligjit për Shëndetësi ndëshkojnë në rastet kur shkelen dispozitat e këtij Ligji.”*

Gjykata gjithashtu vlerëson se sipas nenit 4 par. 1, pika 19 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2010 për Dokumentet Shëndetësore (UA nr. 02/2010) përcaktohet se: *“1. Dokumentet Shëndetësore të unifikuara dhe standardizuara sipas thirrjes dhe shifrimit janë: 1.9. Regjistri i pacientëve – DB02”*. Në nenin 6 par. 11 të UA nr. 02/2010 janë përcaktuar tiparet e dokumenteve shëndetësore si në vijim: *“Regjistiri i pacientëve: Libër me lidhje të fortë, formati 25x35cm; Kopertina: karton i presuar me trashësi 2.25mm e veshur me pëlthurë; Ngjyra e kaltërt e mbyllt; Shkronjat ngjyrë të bardhë; shtypi njëgjyres i dyanshëm”* Gjithashtu në nenin 13 par.1 të UA nr. 02/2010 përcaktohet se: *“Mos përdorimi i dokumenteve shëndetësore të cilat përfshinë ky Udhëzim Administrativ në institucionet shëndetësore të KPSH, KDSH dhe KTSh parashihen masa ndëshkuese në vlerë prej 2,000€.”*

Prandaj, gjykata vlerëson se Kryeinspektori Shëndetësor ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur me vendimin nr. prot. 05-5609/2 të datës 19.09.2018 ka refuzuar ankesën e paditësit kundër Vendimit me nr. prot. 05-5242 të datës 06.08.2018.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimin e të autorizuarit të paditësit të dhënë në padi se përcaktimi i dispozitës së shkëlur vetëm në arsyetim e jo edhe në dispozitiv të vendimit të

atakuar, paraqet shkelje esenciale me rëndësi absolute dhe si e tillë e bënë vendimin e atakuar të pazbatueshëm, por gjykata vlerëson se një pretendim i tillë nuk ka mbështetje ligjore pasi që me nenin 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative është përcaktuar se: *“1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmblyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.”*

Gjykata vlerëson se vendimi kontestues, është hartuar në përputhje me dispozitat e LPPA-së dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme të aktit administrativ dhe vlerëson se dispozita e lartcekur nuk përcakton se në dispozitiv të aktit administrativ duhet të ceket dispozita e shkelur dhe se përcaktimi i nenit në arsyetim të vendimit kontestues i përmbush kërkesat nga LPPA.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe Aktvendimin për fillimin e procedurës së falimentimit IV.EF.nr. 2/2022 të datës 11.02.2022 ndaj subjektit A... Sh.p.k., por vlerëson se sipas nenit 26 të Ligjit për Falimentimin, hapja e rastit të falimentimit nuk ndikon në kërkesat, procedurat ose vendimet e debitorit ndaj palëve të treta por vetëm në kërkesat, procedurat ose vendimet e palëve të treta ndaj debitorit.

Gjykata në këtë çështje ka administruar të gjitha provat e bashkangjitura nga përfaqësues i të paditurit me përgjigje në padi, por vlerëson se të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje dhe nuk ishin të ndërlidhur me vendimin e kundërshtuar me padi. Prandaj për provat: Vendim nr. prot. 05-5241 i datës 06.08.2018; Faturë për pagesën e gjobës datës 02.08.2018; Ankesë nr. prot. 05-5642 e datës 23.08.2018; Vendim nr. prot. 05-5642/2 i datës 20.09.2018; Fletë lëshim për pacientin M.Z, gjykata nuk paraqiti arsyetim të veçantë pasi që të njëjtat ishin jo relevante për këtë çështje.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.26/22, datë 13.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.